



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**

14-020/04-52583/24, më 23 APR 2024

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale dhe të dispozitave të nenit 52 dhe 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni për Shqyrtimin e komenteve dhe ankesave të qytetarëve për Planin rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria".
2. Komisionin nga pika 1 e këtij Vendimi e përbëjnë:
  - 2.1. Florim Krasniqi - Kryesues;
  - 2.2. Fatos Dibra - Anëtar, dhe
  - 2.3. Kushtrim Domaneku - Anëtar.
3. Detyrë e Komisionit nga pika 2 e këtij Vendimi është shqyrtimi i të gjitha komenteve, vërejtjeve, sugjerimeve dhe ankesave të qytetarëve të cilat Kryeqyteti i pranon gjatë fazës së diskutimit publik në lidhje me Planin rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria".
4. Komisioni pas përfundimit të punës do t'i paraqes raport me shkrim Kryetarit të Kryeqytetit për komentet e pranuar dhe të inkorporuara në planin rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria", si dhe një arsyetim me shkrim për komentet e refuzuara.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**U dorëzohet:**

- Anëtarëve të Komisionit;
- Qendrës për Shërbim me Qytetarë;
- Në dosje.

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**

Përparim Rama

